REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr._____Prot

Prrenjas më ____/____/2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë____/____/2026

"PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT VENDOR RINOR"

Në mbështetje të nenit 54, të Ligjit nr. 139/2015 ''Për Vetëqeverisjen Vendore'' i ndryshuar, të Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", i ndryshuar, neni 7 dhe neni 10, pika 2 "Këshilli Vendor Rinor", me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 263, datë 18.06.2026 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aplikimeve për Këshillin Vendor Rinor Prrenjas, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Prrenjas në mbledhjen e datës__/___/ 2026.

VENDOSI:

1. Të ngrihet, organizohet dhe të funksionojë Këshilli Vendor Rinor (KVR), organ këshillimor, pranë Bashkisë Prrenjas me qëllim të përfshirjes, pjesëmarrjes dhe mbështetjes të të rinjve në kompetenca në nivel vendor.
2. Këshilli Vendor Rinor ushtron funksionet e tij në përputhje me Ligjin nr. 75/2019 "Për Rininë"i ndryshuar, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe rregulloren përkatëse të miratuar nga Bashkia Prrenjas.

3. Anëtarët e Këshillit Vendor Rinor ushtrojnë mandatin e tyre me afat dy vjeçar me të drejtë rizgjedhje sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të Bashkisë Prrenjas.
4. Ngarkohet Strukturat përgjegjëse për rininë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6 e ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" si edhe pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

BASHKIA PRRENJAS - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr____ Prot

Prrenjas, më ____.____.2026

PROJEKT – VENDIM
NR _____ DATË____.____.2026

"PËR MIRATIMIN PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029(FAZA 1) PËR BASHKINË PRRENJAS"

- Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore'' neni 54, pika dh ,të Ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore'', neni 36,të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqiperisë " , I ndryshuar në Udhëzimin Nr.9 Datë 20.03.2018 . *"Për procedurat standarte të zbatimit të* Buxhetit*",Udhëzimin Nr.8 Datë 28.02.2025"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029"*,referuar Relacionit të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029, Kryetari I Bashkisë I propozon Këshillit Bashkiak:

- Të miratojë "Parashikimin e burimeve të të ardhurave të Bashkisë Prrenjas për vitet buxhetore 2027-2029".
- Të miratojë "Planifikimin e tavaneve afatmesme të shpenzimeve për Bashkinë Prrenjas" sipas Formateve.
- Të miratojë "Investimet afatmesme në nivel program të Bashkisë Prrenjas" sipas Formateve.
- Për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit Financiar , Drejtoria e B.Njerezore dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit,Kontrollit tëTerritorit dhe Pronës si edhe Institucionet në varësi të Bashkisë Prrenjas.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar si dhe pas shprehjes së ligjshmërisë së Prefektit të Qarkut Elbasan.

- Bashkangjitur Relacioni I Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr._____prot. Prrenjas, më___.___.2026

PROJEKT - VENDIM

Nr._____Datë_____

"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike me 6% të fondit të kushtëzuar të bllok ndihmës ekonomike muaji MAJ 2026 ".

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57, datë 18.07.2019 ' Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë', bazuar gjithashtu në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i azhornuar me ligjin nr.10399 datë 17.03.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin në.9355 datë 10.03.2005 " Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar në nenin 7, në VKM nr.787 datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", si dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, administratorja e zyrës së ndihmës ekonomike i propozon Këshillit të Bashkisë, të trajtohen me ndihmë ekonomike me kriter të veçantë:

1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale,
3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune,
4. Familje me shumë fëmijë
5. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që ndjekin universitetin;
6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/invalidë pune

I propozoj Këshillit të Bashkisë të trajtohen nga fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike për muajin ***MAJ , 40*** familje me fond **186.192 LEKË.**

Përgjegjës i Shërbimit Social
Besim HANA

KRYETAR I BASHKISË
NERI BELBA
NE MUNGESE DHE ME URDHER
ZV/KRYETAR I BASHKISE
AFRIL KARRIQI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT,MENAXHIMIT FINANCIAR
DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr._____ prot. Prrenjas, më_____._____.2026

PROJEKT –VENDIM

Nr._____Datë_____._____.2026

"PËR
MIRATIMIN E PËRDORIM TË FONDI REZERVË PËR VITIN 2026"

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015"Për veteqeverisjen vendore",të ndryshuar, Ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" të ndryshuar, Neni 6,15,17 dhe 44 Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë",të ndryshuar, Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" dhe ligjit nr. 87 datë 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", V.K.B Nr.90 Prot. Datë 24.12.2025 Për Miratimin Përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxheti 2026",me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pasi u shqyrtua relacioni shpjegues i Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit Territorit,Aplikimit të Projekteve dhe Pronave nga GMS , në mbledhjen e datës :_____.____.2026 **Këshilli Bashkiak**

V E N D O S I :

1. **Të miratojë pakësim në zërat e Buxhetit për fondin Rezerve sipas strukturave përkatëse si më poshtë:**

NR	EMËRTIMET	Kod projekti	GR.	TIT.	KAP.	ART.	SHUMA
1.	FOND REZERVE	9999999	00	04980	01	609	2,493,581
	TOTALI						2,493,581

2. **Të shtohen në zërat e buxhetit sipas strukturave përkatëse si më poshtë:**

NR	EMËRTIMET	Kod projekti	GR.	TIT.	KAP.	ART.	SHUMA
1	"Furnizim dhe vendosje kangjellash mbrojtëse në trotuarin,pranë rrugës nacionale,Qyteti Prrenjas		00	04520	01	231	2,493,581
	TOTALI						2,493,581

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit,Zhvillimit Territorit,Aplikimit te Projekteve dhe Pronave, Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria Juridike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETARI I BASHKISË

Nuri Belba